REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS/VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E DREJTËSISË/MINISTARSTVO PRAVDE
MINISTRY OF JUSTICE
Nr.Br.No: 01-277/2
Data/Datum/Date: 05/05/2026
Shtojcat/Dodaci/Aneks: -2-
PRISHTINË/A

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Kabineti i Ministres së Drejtësisë - Ured Ministarke Pravde - Office of the Minister of Justice

---

Nr. 80/2026
Datë: 04/05/2026

Në mbështetje të neneve 9, 10 (paragrafi 1 dhe 2) dhe nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, duke u bazuar në nenin 11 (paragrafi 1, nënparagrafi 1.5) të Ligjit nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në përputhje me nenin 29 (paragrafi 1, nënparagrafi 1.4) të Ligjit nr. 08/L-191 për Ekspertët Gjyqësorë, si dhe në pajtim me nenin 6 të Rregullores (QRK) - nr. 04/2026 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Ministrive, Zëvendëskryeministrja dhe Ministrja e Drejtësisë në detyrë, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e z. Jahir Shala, ekspert gjyqësor i kardiologjisë, për dorëheqje nga lista e ekspertëve gjyqësorë.

2. Emri i z. Jahir Shala shlyhet nga regjistri i ekspertëve gjyqësorë në pajtim me nenin 30 të Ligjit nr.08/L-191 për Ekspertët Gjyqësorë.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Departamenti për Politika të Sistemit të Drejtësisë, Profesione të Lira dhe Statistika në Ministrinë e Drejtësisë.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Z. Jahir Shala, me datë 27.02.2026, ka paraqitur në Ministrinë e Drejtësisë kërkesën me numër protokolli 01-277 për dorëheqje nga pozita e ekspertit gjyqësor të kardiologjisë, për shkaqe profesionale. Dorëheqja është paraqitur si rezultat i angazhimeve të shumta profesionale, të cilat e pamundësojnë përfundimin e ekspertizave brenda afateve të përcaktuara.

Në pajtim me nenin 29 (paragrafi 1, nënparagrafi 1.4) të Ligjit nr. 08/L-191 për Ekspertët Gjyqësorë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Donika Gërvalla-Schwarz

Zëvendëskryeministre dhe Ministre e Drejtësisë në detyrë

Vendimi u dërgohet:

- *Z. Jahir Shala;*
- *Kabinetit të Zëvendëskryeministres dhe Ministres së Drejtësisë në detyrë;*
- *Sekretarit të Përgjithshëm;*
- *Këshillit Gjyqësor të Kosovës;*
- *Këshillit Prokurorial të Kosovës;*
- *Departamentit për Politika të Sistemit të Drejtësisë, Profesione të Lira dhe Statistika;*
- *Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë;*